



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Planimë / Dorezuar Priljeva / Predato Received / Delivery	11.05.2022	2	viti god year
Organ / Objekta Organ / Jednica Org. / Unit	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOPSHTICK	2724/2022		113



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 382/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani kryetar Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Kocanëtarë, dhe Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, kanë shqyrtuar ankesën A. Nr. 382/2022 të datës 15.04.2022, të parashtruar nga ankuesi grup ankuesish me avokat me adresë banimi nga Komuna e Mitrovicës, kundër organit të punësimit Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina", në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1.1 nën paragrafin 1.1, nenin 16, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimi dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 11.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A. Nr. 382/2022 të datës 15.04.2022, të parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi grup ankuesish më datë 15.04.2022, përmes avokatit kanë parashtruar ankesë me numër protokolli 2152/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me pretendimet ankimore, lidhur me kompensimin e pagesës me shumën prej 30 euro, sipas vendimit nr. 05/24, të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të datës 12.01.2018.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, me qëllim të vërtetimit të plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike dhe bazës juridike, për marrjen e vendimit meritore ka administruar këto prova: Ankesën e datës 15.04.2022, e parashtruar nga ankuesi me numër protokolli



2152/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesa e datës 07.03.2022, drejtuar Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave, pranë Universitetit të Prishtinës

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, ka shqyrtuar pretendimit ankimore të grup ankuesit

lidhur me kompensimin e pagesës me shumën prej 30 euro, sipas vendimit nr. 05/24, të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Kolegji ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, duke ju referuar nenit 2 paragrafit 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, i cili përcakton se zyrtarët publikë janë ndarë në: *nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); nëpunësi i Shërbimit Publik; nëpunësi i Kabinetit; dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës*, si dhe bazuar në paragrafin 4 të të njëjtit nen ku përcaktohet se: *"Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike"*, konstaton se të gjithë të punësuarit në fushën e arsimit në këtë rast edhe pozitat e ankuesve hyjnë në kategorinë e nëpunësit të shërbimit publik, rrjedhimisht këto pozita nuk hyjnë në kategorinë e nëpunësit të shërbimit civil.

Ndërlidhur me kategorinë e nëpunësve të shërbimit publik pjesa V e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, gjegjësisht neni 64 paragrafi 1 i këtij ligji, ka përcaktuar që: *"Përveç sa parashikohet shprehimisht ndryshe në këtë pjesë të Ligjit, marrëdhënia e punësimit për nëpunësin e Shërbimit Publik rregullohet sipas dispozitave të Ligjit të Punës"*, ndërsa neni 67 i Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përcakton se: *"Themelimi i marrëdhënies së punës për një nëpunës të Shërbimit Publik bëhet vetëm në bazë të një konkursi publik dhe të hapur, të organizuar sipas këtij ligji"*.

Bazuar në nenin 74 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është përcaktuar që: *"1. Zyrтари i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit. 2. Ankimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit"*, si rrjedhojë nëpunësit e shërbimit publik, kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente, siç parashihet me nenin 24 paragrafi 4 të këtij ligji.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se Këshilli është kompetent për të shqyrtuar vetëm ankesat e nëpunësve civilë dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civilë si dhe duke marr parasysh faktin se pozita ku ka aplikuar ankuesja ka statusin e nëpunësit të shërbimit publik, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, konstaton

se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk është kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e parashtruar nga ankuesit.

Si u tha më lartë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës

Lënda Nr. A. Nr. 382/2022

Rushit KAJTAZI

Procesmbajtës

Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Avokatet *përfaqësuesit të ankueseve;*
- Sekretarit të Përgjithshëm të Universitetit të Prishtinës „Hasan Prishtina”.
- Udhëheqësit të Personelit në Universitetin e Prishtinës „Hasan Prishtina”
- Arkivit të KPMSHCK-së

